REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 129/17
Datë/Datum. 11.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Ak	Menaxherin e prokurimit: **QKUK**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP Nr.129/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Furnizimi me gazra medicinale"**, me nr. prokurimi: **QKUK-701-17-002-111.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE N.P.T.SH. "Bubeari Komerc – Kaçanik.**		
Datë	**11.05.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi me gazra medicinale",** me nr. prokurimi: **QKUK-701-17-002-111,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **QKUK,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: OE **N.P.T.SH. "Bubeari Komerc"**, me seli në Ferizaj, me nr.prot.**129/17**, i datës 28.04.2017

Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		03.05.2017		04.05.2017		11.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 28.04.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit 129/17, e parashtruar nga operatori ekonomik **N.P.T.SH. "Bubeari Komerc"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizimi me gazra medicinale"**, me nr. prokurimi: **QKUK-701-17-002-111**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **QKUK**.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-Operatori Ekonomik Ankues: **N.P.T.SH. "Bubeari Komerc – Kaçanik, Kosovë.**

Pikat e Ankesës:

Neni 6 i LPP-së, (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti),

Neni 7 i LPP-së, (Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi),

Neni 52 i LPP-së, (Njoftimi i kritereve per dhenien e kontrates),

Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve),

Neni 68 i LPP-së, (Gjendja Ekonomike dhe Financiare),

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Duke u bazuar ne procesverbalin e hapjes se tenderit dhe pikes 31.1 te dosjes së tenderit wshtw bw shkelje nw proceduren e vlersimit nga ane e komisionit pwr vlerwsim ose komisioni ka qen jo profesional. Vendimin pwr ankese nw OSHP e morem pas kwrkeses pwr rishqytrim nw AK.
AK-ja ka shpall fitues operatorin ekonomik per 25% me tw shtrejt se oferta e jonwe pa na njoftu per vlersimin e komisionit per eliminim.Fituesi eshte shpall me 07.0402017,eshte publiku me 11.04.2017 ne kemi man letren standatde per eliminim pas kerkeses per informacion rreth aktivitetit te prokurimit(te gjitha e-mailet ja bashkangjesim ankeses).Me daten 18.04.2017 kemi dorzu kerkesen per rishqyrtim pasdite me 19.04.2017 ora 9:32 kemi man njoftimin per pezullim te nenshkrimit te kontrates,ora 11:02 kenmi man njoftimin per heqje pezukkimi,shtrohet pyetja qka u rishqyrtu?

Sipas mendimit tone vendimi per eliminim eshte pa baze sepse llogaritja e qmimit eshte ba jo konform

ligjit dhe realitetit objektiv.

Sipas nenit 59 te LPP-se llogaritja nese ka gabime aritmetikore ne kete rast mirret per baze cmimi i ofiuar njesi e jo çrnimi I ofruar me TVSH,Sepse vlera e TVSH-se eshte prone e ATK-se e jo autoritetit kontraktues e as operatorit ekonomik.Ne tender keni kerkuar shkallen e TVSH-se ne pergindje(%) ku sipas ATK-se rrumbullaksohet ne numer te perafert e jo te shkurtohet, por nese autoriteti kontraktues e men per baze cmimin njesi te ofruar gabimet aritmetikore do te jene ne diapazonin nen 2%.S

Kerkoj nga KRPP dhe komisioni i vleresimit ge te rishqyrtojne vendimin e marre ku sipas meje dhe LPP-se kane bere gabime ne vlersim sepse si operator ekonomik kam gene afer 25% me i lire dhe si furnitore gjate tenderit te kaluar nuk kam pase asnje vrejtje,pohoj dhe garantoj se prap do ta furnizoje ne te njejten menyre. Ligji per TVSH LO5-037 paragrafi 4 neni 39 te shikohet dhe AK- nuk ka dhan shpejgim per refuzimin ne kerkesat tona.

Oksigjen I gazet kg 70000 0,34 1,18 28.084,00

Oksigjen I gazet kg 4000 0,34 1,18 1.604,80

Acetilen kg 60 2,80 1,18 198,24

Oksidul N20 kg 40000

CO2 kg 800 0.25 1.18 236.00

CO2 kg 200 0.25 1.18 59.00

Oksigjen I lenget lit - 540000 0.13 1.18 82.836.00

Azot I lenget lit. - 1640 0.80 1.18 1.548.16

Sipas llogaritjes tone qmimi njesi per oskigjenin e lenget ka qene 0.135 edhe nese rrumbullaksohet ne 0.13 apo nuk merret parasysh decimalja e tret si ne rastin e paraqitur ne tabele gabimi aritmerik eshte 3186.00 € ma I vogel se 2% ose me I vogel se vlera e 3771.04 € e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues.

Propozoj nga Organi shqyrtues I prokurimit qe ky aktivitet I prokurimit te kthehet ne RI-VLERSIM.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....30.01.2017
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....Furnizim/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 10.03.2017
Data e hapjes së ofertave (N.58):.....10.03.2017-ora 13;30h
Njoftimi për dhënien e kontratës.....11.04.2017
Kriter për dhënien e kontratës.....Çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Lote	Çmimi	Vëretje
1	"Shala Gas"	Suharekë	-	362,328.68€	JO
2	"Masser GTM"	Mitrovicë	-	235,200.42€	JO
3	Sol-K sh.p.k	Prishtinë	-	273.783.60€	JO
4	Bubeari Komerc	Kaçanik	-	188,552.20€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit **Furnizimi me gazra medicinave**, ka marrë pjesë kater (4) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes NUK është rexhistruar vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Dëshmia e kërkuar dokumentare: Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP). 1.Nje deklarate e shkruar nen betim,e nenshkruar nga tenderuesei duke perdorur formen ne Aneksin 2. Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon: a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d,e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. (origjinali ose kopja e noterizuar) Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)],vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit QKUK ka ndër mend që t'ia jap kontratën.Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5)ditë nga marrja e njoftimit të QKUK, për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur,do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe QKUK do të vazhdojë me tenderuesin e radhes ne rang-liste.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
Kërkesa 1. Certifikatë e regjistrimit të biznesit,regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës nëvendin e juaj te themelimit. Kërkesa 2. Certifikatë e numrit fiskal . Kërkesa 3. Certifikatë e TVSh-së

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Evidenca 1. Te dëshmohet me Certifikatë te Regjistrimit te Biznesit si dhe me informacione te biznesit- Kopje. Evidenca 2.Te dëshmohet me Certifikatë te Numrit Fiskal- Kopje. Evidenca 3.Te dëshmohet me Certifikatë te TVSh-së – Kopje.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Kerkesa 1. Qarkullim nga Administrata Tatimore e Kososves per furnizime te ngjashme

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Deshmia 1.Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës ne tri vitet e fundit (2014,2015 dhe 2016) te kete min. 500,000.00 € qarkullim

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kerkesa 1.Furnizimet e rendesishme te operatorit ekonomik per furnizim me gazra medicinale.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Deshmia 1.Lista ku jane te specifikuara furnizmet e rendesishme te operatorit ekonomik per furnizim me gazra medicinale per tri vitet e fundit (2014,2015 dhe 2016),duke saktesuar produktet e furnizuara,shumen e kontrates,daten dhe pranuesin.Per deshmi te ketij livrimi duhet kopja e referencave te ketyre furnizimeve te nenshkruara nga autoriteti i tille (pranuesi).
Kerkesa 2: Autorizim nga Prodhuesi
Kerkesa 3: Kualiteti i produkteve
Deshmia 2: Autorizim nga Prodhuesi
Deshmia 3: Deklarate te kualitetit nga prodhuesi.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Ramadan KAQIU: Kryesues,
Pranvera GASHI: Anëtar,
Asan HAXHA; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 31.03.2017.

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka REKOMANDUAR për dhënien e kontratës OE MESSER GTM L.L.C, me seli në Mitrovicë, me çmim 232,791.20€.

Komisioni vlerësues pas vlerësimit,ekzaminimit të ofertave ka shpallur të papërgjegjshëm operatorin ekonomik:
NTSH SHALA GAS, si dhe OE BUBEARI Komerc, ndërsa si operator të përgjegjshëm ne këtë aktivitet të prokurimit janë shpallur: OE MESSER GTM si dhe OE SOL-K sh.p.k.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedur të hapur, kontrat për furnizim me vlerë të madhe, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi përgjegjshëm me çmimi më të ulët". I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës, të datës 11.04.2017, për këtë aktivitet të prokurimit, operatoret ekonomik ankues, ka parashtruar ankesë në OSHP me datë 28.04.2017, me pretendimet ankimore se janë shkelur neni:

Neni 6 i LPP-së, (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti),

Neni 7 i LPP-së, (Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi),

Neni 52 i LPP-së, (Njoftimi i kritereve per dhenien e kontrates),

Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve),

Neni 68 i LPP-së, (Gjendja Ekonomike dhe Financiare),

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor1,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket arsyes të eliminimit të OE ankues nga ana e komisionit vlerësues në lidhje me çmimet,

Eksperti shqyrtues bazuar në listen e çmimeve të ofertës së OE ankues, vlerëson se qëndron pretendimi ankimor, njëherit arsyetimi i dhënë nga ana e komisionit vlerësues është i pabazuar, për faktin se OE ankues ka ofruar çmime për njësi nw përshkrimin e çmimeve nw pothuajse gjithsej pozicionet, çmim me dy (2) numra pas pikës dhjetore, duke prejashtuar vetëm pozicionin nr.7 (oksigjen i lënget) ku ka ofruar çmim 0.135 për njësi pa TVSH, dhe në këtë rast çdo numër i shënuar pas numrit te dyte (2) nuk do te merret për baze ne llogaritje te vlerës se ofertës sipas nenit 18.3 të UDHRRPP, në rastin konkret gjatë ekzaminimit të këtij pozicioni kur të shumëzojme çmimin për njësi duke e shumëzuar vetëm dy numrat pas pikës dhjetorë rezulton se ndryshimi në çmimin total NUK e kalon vlerën prej 2% të gabimit aritmetik siç pretendon autoriteti kontraktues.

Eksperti shqyrtues vlerëson se Autoriteti kontraktues ka devijuar gjatë ekzaminimit të ofertës financiare të OE ankues sa i përket llogaritjes së çmimit, duke kalkuluar TVSH, ku OE ankues pas kalkulimit të çmimit për njësi me TVSH e aplikuar, ka rezultuar me më shumë se dy numra pas pikës dhjetore për secilin çmim për njësi, Eksperti shqyrtues në këtë rast i s'qaron Autoriteti kontraktues se NUK mundet të ndryshohet vlera e çmimit të kalkuluar pas TVSH, pasi që TVSH është taksë e aplikuar e shtetit të cilen nuk mundet të ndryshohet apo modifikohet, në rastin konkret duhet të mirret parasysh vetëm çmimi ofruar nga OE, siç është paraqitur në oferten financiare të OE ankues, sa i përket pozicionit nr.7 te

përshkrimi çmimit, ndryshimi në këtë pozicion duke i marrur për bazë pas pikës dhjetore vetëm dy numrat si në vijim: pozicioni nr.7-(540,000.00litra x 0.13=70,200.00 x 1.18 TVSH-ja =82,836.00€, ndryshimi i këtij pozicioni me çmimin e vendosur në listen e çmimeve të ofertë të OE ankues është : (86,022.00€, çmimi dhënë në ofertë duke e zbritur me çmimin e përmisuar që është 82,836.00€= diferenca apo dallimi në çmimin total të ofertes 3,186.00€), që është në harmoni me nenin 59.3 të LPP-së, duke mos kaluar më shume se 2% të vlerës totale të ofertës, pasi që çmimi i total i ofertës është 188,552.20€, gabimi aritmetik është 3,186.00€ = ndryshimi i vlerës së ofertës është =1.69%.

Eksperti shqyrtues gjatë ekzaminimit të ofertës financiare të OE ankues vlerëson se në rastin konkret NUK kemi të bëjmë me ofertë financiare manipuluese për qka edhe parashihet me nenin 18.3 të Udhëzuesit Regullativ për Prokurim Publik, që të sanksionohen OE që ofroj çmime manipulative duke përdor çmime shumë shifrore pas pikës dhjetore siç kemi pasur në praktikat e kaluara, në rastin konkret lidhur me këtë ofertë vetëm një pozicion është ofruar me çmim 3 shifror pas pikës dhjetore (0.135€) që është normale duke u bazuar në natyren e furnizimit të këtij produkti pasi që kemi të bëjmë me çmim të ulët të produktit.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si të BAZUARA ankesën OE NPTSH "BUBEARI", me seli në Kaçanik, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të ANULOJ vendimin "Njoftimi për dhënien e kontratës, i datës 11.04.2017, me titull: "Furnizimi me gazra medicinave", me nr. prokurimi: QKUK-701-17-002-111, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – QKUK", dhe ky aktivitet i prokurimit të kthehet në RI-VLERËSIM.